

## Vllaznia/ Drejtuesit paralajmerojne largime ne mase

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 25 Dhjetor 2013 22:45

---



Tifozet jane te pakenaqur, drejtuesit njesoj si dhe ata. Lojtaret jane te akuzuar ndersa trajneri Agim Canaj eshte i konfirmuar. Pak dite pasi ka perfunduar kampionati, drejtuesit e Vllaznise i kane bere te ditur lojtareve se mes tyre do te kete shume qe nuk do te luajne me per skuadren shkodrane. Ne janar pritet te kete nje numer te madh largimesh dhe nje numer po kaq te madh afrimesh. Lojtare te huaj dhe shqiptare jane nen vezhgim gjate ketyre diteve dhe shume shpejt do te kete zhvillime ne Shkoder.